



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

Nr. 2536/21 prot.

Elbasan, më 12.12.2023

KONTRATE PUBLIKE PËR FURNIZIMIN E MALLRAVE
"Loti I - Blerje materiale kancelarie"

E lidhur sot, më datë 12.12.2023 në zyrat e Universitetit i Elbasanit "A.Xhuvani", mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr.162/2020 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM-ja nr.285 dt.19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullat e Prokurimit Publik" sipas kushteve të mëposhtme:

A. KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Mallra)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

- Autoriteti Kontraktor është - **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**, përfaqësuar nga **Administratori z. Eljan Hoxha**, njohur më poshtë si "**Autoriteti kontraktor**" (Blerësi Publik).
- Kontraktuesi është Operatori Ekonomik "**InfoSoft Office**" shpk, i përcaktuar më poshtë si "**KONTRAKTUESI**" (sipërmarrësi), me seli në Tiranë, i regjistruar më dt. 29.07.1994, me NIPT me nr. **J62426002Q**, me administrator (drejtues ligjor) **z. Frederik Prodani**, i cili përfaqëson këtë subjekt për detyrimet e kësaj kontrate, më poshtë i referuar si **KONTRAKTUESI** (personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra).

Neni 2: Objekti i kontratës dhe sasia e mallit

Mbi bazën e dokumentacionit që disponon pas fitimit të prokurimit publik të zhvilluar në datë 06.11.2023, do të kryej furnizimin për objektin: "**Loti I - Blerje materiale kancelarie**", sipas aneksit të kontratës.

Neni 3: Specifikimet teknike të mallit

Cilësia dhe specifikimet teknike të mallit objekt kontrate do të jenë ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit (shtojca 5) dhe të pranuar nga Kontraktuesi në dokumentat e ofertës të paraqitura nga ky operator ekonomik në tenderin e zhvilluar nga autoriteti kontraktor në datë 06.11.2023.

Adresa: Rruga "Ismail Zyra", Elbasan, Tel. +355 54 252593, www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al



Neni 4: Çmimi i Kontratës.

Vlera totale kontratës (pa tvsh) është **1,536,850** (Njëmilion e pesëqind e tridhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë. **Vlera e plotë e kontratës (me tvsh)** që do ti paguhet kontraktuesit është **1,844,220** (Njëmilion e tetëqind e dyzet e katërmijë e dyqind e njëzet) lekë.

Neni 5: Sigurimi i Kontratës

Garancia e kontratës e paraqitur nga Kontraktuesi para lidhjes së kontratës, sipas modelit përkatës dhënë në dokumentat e tenderit ka vlerën 10% të vlerës së kontratës në shumën absolute **184,422 lekë**. Kjo shumë do të garantojë autoritetin kontraktor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi (shitësi).

Çlirimi i garancisë së kontratës do të bëhet me shkrim nga Blerësi Publik, 30 ditë pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi.

Neni 6: Fillimi i zbatimit dhe mënyra e levrimit

Lëvrimi i mallit do të kryhet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës sipas aneksit të kontratë bashkëngjitur.

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet, për cilësinë e mallit.

Kontraktuesi garanton që malli do të plotësojë të gjitha kërkesat për cilësinë dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit .

Në çdo moment që autoriteti kontraktor konstaton se malli i lëvruar nuk ka cilësinë dhe specifikimet teknike të kërkuara, ai i kërkon kontraktuesit dhe ky i fundit është i detyruar të furnizoj pa pagesë një sasi tjetër të barabartë me sasinë e furnizuar më parë, e cila plotëson kërkesat për cilësi dhe specifikimet teknike të kërkuara.

Neni 8: Kushtet e Dorëzimit

Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit. Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë gjithë ditëve pune të javës dhe në çdo kohë në magazinën e Autoritetit Kontraktor.

Neni 9: Kushtet e Pagesës

Pagesa do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues (faturës) të rregullt, të pranuar nga autoriteti kontraktor, **brenda 1 (një) muaji** nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është **Lek**.

Numri i llogarisë bankare të Kontraktuesit është në [REDACTED]

[REDACTED] Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

Neni 10: Zgjidhja e kontratës

Kontrata mund të zgjidhet duke pushuar çdo efekt të saj me njoftimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktor në rastet e mëposhtme :

1. Në rastin e mosfurnizimit të sasisë së plotë të mallrave sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.
2. Në rast mosplotësimi të kërkesave të cilësisë së mallit objekt kontrate dhe mospranimit nga Kontraktuesi për zëvendësimin e kësaj sasive me një sasi tjetër të barabartë me të parën, që i përmbush këto kërkesa pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e mësipërm kontrata do të zgjidhet duke respektuar dispozitat e Kodit Civil.



Neni 11: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për çdo marrëveshje që mund të lind në zbatimin e kontratës, nëse ato nuk zgjidhen në marrëveshje midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK) Procedur e Hapur e Thjeshtuar

Neni 1: Dispozitat e përgjithshme

1.1 Përkufizimet

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.1 Kontrata

1.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 25.

1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Mallrave objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7 "Vizatimet" do të thotë vizatimet e Mallrave, siç janë përfshirë në Kontratë, dhe çdo vizatim shtesë dhe i modifikuar i lëshuar nga (ose në emër dhe për llogari të) Blerësit në përputhje me Kontratën.

1.1.1.8 "Katalog" do të thotë një "libër" që përmban listën e produkteve/mallrave përfshirë përshkrimet e cilësive/specifikimeve, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

1.1.1.9 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.10 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.11 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.12 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2 Palët e Kontratës

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Mallrave objekt kontrate.

1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që furnizon Mallrat objekt kontrate.

1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të Mallrave ose Shërbimeve të Lidhura me to.

1.1.3 Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi

- 1.1.3.1 "Test i Pranimit" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me Specifikimet për qëllimin e pranimit të Mallrave.
- 1.1.3.2 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

1.1.4 Mallrat

- 1.1.4.1 "Mallra" do të thotë të gjitha mallrat, lënda e parë, makineritë dhe pajisjet dhe / ose materialet e tjera që Furnizuesit duhet t'i furnizojnë Blerësit sipas Kontratës.
- 1.1.4.2 "Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me furnizimin e Mallrave, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

1.1.5 Përkufizime të tjera

- 1.1.5.1 "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- 1.1.5.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 22 "Forca Madhore".
- 1.1.5.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 10 "Sigurimi i Kontratës".
- 1.1.5.4 "Vendi i dorëzimit të Mallrave", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- 1.1.5.5 "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- 1.1.5.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- 1.1.5.7 "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK
- 1.1.5.8 "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- (a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- (b) fjalët që tregojnë njëjës in përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjës in;
- (c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

1.2.2 Inkotermat

- (a) "Inkotermat" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- (b) Përveçse kur nuk është në përputhje me ndonjë dispozitë të Kontratës, kuptimi i çdo termi tregtar dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve në të do të jenë siç përshkruhet nga Inkotermat.
- (c) Inkotermat, kur përdoren, rregullohen nga rregullat e përshkruara në botimin aktual të Inkotermave, të specifikuara në KVK, dhe të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

1.2.3 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.



1.2.4 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

1.2.5 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

1.3 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënie ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rena dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa. Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

1.4 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë. Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Furnizuesi.

1.5 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

1.6 Hartimi i Kontratës

1.6.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

E drejta e autorit

1.6.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe

informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

1.7 **Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Mallrave të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

1.8 **Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës 1.9 (a) këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penalteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar Nenin 7.1.

1.9 **Përgjegjësia e përbashkët dhe solidarë**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

1.10 **Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**



Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluar, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2: Praktikave të Ndaluar

- 2.1. Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluar në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.
- 2.2. Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme. Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

Neni 3: Njoftimet

- 3.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.
- 3.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 4: Objekti i Furnizimit

- 4.1 Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.
- 4.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

Neni 5: Dorëzimi

- 5.1 Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni 6: Përgjegjësitë e Furnizuesit

- 6.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektivin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni 7: Çmimi i Kontratës

- 7.1 Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

Neni 8: Kushtet e Pagesës

- 8.1 Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK. Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

- 8.2 Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.
- 8.3 Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
- 8.4 Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Neni 9: Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera

- 9.1 Për Mallrat e prodhuara jashtë vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifafat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Blerësit.
- 9.2 Për Mallrat e prodhuara brenda vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifafat e licencës, etj., të lindura deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara tek Blerësi.
- 9.3 Nëse në vendin e Blerësit, mund të jetë i disponueshëm për Furnizuesin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Blerësi duhet t'i krijojë mundësi Furnizuesit të përfitojë nga këto lehtësira.

Neni 10: Sigurimi i Kontratës

- 10.1 Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 10.2 Në përputhje me Nenin 10.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
- 10.3 Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
- 10.4 Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

Neni 11: Nënkontraktimi

- 11.1 Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
- 11.2 Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.
- 11.3 Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

Neni 12: Specifikimet dhe Standardet

- 12.1 Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura të jenë në përputhje me Kërkesat Teknike, siç specifikohet në Dokumentet e Tenderit.



Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Blerësi, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Furnizuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Blerësin për të.

Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Blerësi dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 23 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127.

Neni 13: Paketimi dhe Dokumentet

13.1 Furnizuesi siguron paketimin e mallrave siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin ose përkeqësimin e tyre gjatë transportit në destinacionin e tyre përfundimtar, siç përshkruhet në Kontratë. Gjatë transportit, paketimi duhet të jetë i tillë që t'i rezistojë ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme, kripës dhe reshjeve dhe kushteve të magazinimit. Madhësia dhe peshat e kutisë së paketimit do të marrin parasysh, kur është e përshtatshme, largësinë e destinacionit përfundimtar të Mallrave.

13.2 Paketimi, shënjimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në përputhje me kërkesat e veçanta siç parashikohen shprehimisht në Kontratë, përfshirë kërkesat shtesë, nëse ka, të specifikuara në KVK, dhe në çdo kërkesë tjetër nga Blerësi.

Neni 14: Siguracioni

14.1 Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me prodhimin ose blerjen, transportin, magazinimin dhe dorëzimin, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.

Neni 15: Transporti

15.1 Përveçse kur përcaktohet ndryshe në KVK, përgjegjësia për organizimin e transportit të Mallrave do të jetë në përputhje me Inkotermat e zbatueshme.

Neni 16: Inspektimet dhe testet

16.1 Furnizuesi do të kryejë me shpenzimet e veta dhe pa asnjë kosto për Blerësin, të gjitha testet dhe / ose inspektimet e tilla të Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to siç specifikohet në KVK.

16.2 Inspektimet dhe testet mund të kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, në pikën e dorëzimit, dhe / ose në destinacionin përfundimtar të Mallrave, ose në një vend tjetër në vendin e Blerësit siç përcaktohet në KVK. Nëse kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, të gjitha lehtësitë dhe ndihma e arsyeshme, duke përfshirë aksesin tek vizatimet dhe të dhënat e prodhimit, do t'u dorëzohen inspektorëve pa pagesë për Blerësin.

16.3 Përfaqësuesit e caktuar të Blerësit kanë të drejtë të marrin pjesë në testet dhe / ose inspektimet e përmendura në Nenin 16.2, me kusht që Blerësi të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet e tij të kryera në lidhje me një pjesëmarrje të tillë duke përfshirë, por pa u kufizuar, të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit.



- 16.4** Kurdoherë që Furnizuesi është i gatshëm të kryejë ndonjë test dhe inspektim të tillë, ai do t'i bëjë një njoftim të arsyeshëm paraprak, Blerësit, duke përfshirë vendin dhe kohën. Furnizuesi do të marrë nga çdo Palë e tretë përkatëse ose prodhues çdo leje ose pëlqim të nevojshëm për t'i mundësuar Blerësit ose përfaqësuesit të tij të caktuar të marrë pjesë në test dhe / ose inspektim.
- 16.5** Blerësi mund të kërkojë nga Furnizuesi të kryejë çdo test dhe / ose inspektim që nuk kërkohet nga Kontrata, por konsiderohet i nevojshëm për të verifikuar nëse karakteristikat dhe performanca e Mallrave përputhen me kodet dhe standardet e Specifikimeve Teknike sipas Kontratës. Blerësi do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Nëse një test dhe / ose inspektim i tillë pengon progresin e prodhimit dhe / ose kryerjen nga ana e Furnizuesit të detyrimeve të tjera të tij sipas Kontratës, Blerësi do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimin.
- 16.6** Furnizuesi do t'i sigurojë Blerësit një raport të rezultateve të çdo testi dhe / ose inspektimi të tillë.
- 16.7** Blerësi mund të refuzojë çdo Mall ose ndonjë pjesë të tij që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është në përputhje me Specifikimet. Furnizuesi do të ndreqë ose zëvendësojë Mallrat e refuzuar apo pjesë të tyre ose do të bëjë ndryshimet e nevojshme për të përmbushur specifikimet pa ndonjë kosto për Blerësin, dhe do të përsërisë testin dhe / ose inspektimin, pa asnjë kosto për Blerësin, pasi të njoftojë në përputhje me Nenin 16.4.
- 16.8** Furnizuesi bie dakord që ekzekutimi i një testi dhe / ose inspektimi i Mallrave ose ndonjë pjesë të tyre, nuk e shkarkojnë Furnizuesin nga garancitë ose detyrimet e tjera sipas Kontratës.

Neni 17: Dëmet e likujduara

- 17.1** Dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

Neni 18: Garancia

- 18.1** Furnizuesi garanton që Mallrat nuk kanë defekte që vijnë nga ndonjë veprim ose mosveprim i Furnizuesit ose që vijnë nga skicimi, materialet dhe punimi nën përdorimin normal në kushtet që mbizotërojnë në vendin e destinacionit përfundimtar.
- 18.2** Blerësi përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi Mallrat, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë dorëzuar dhe pranuar në destinacionin përfundimtar të përshkruar në KVK.
- 18.3** Blerësi do të njoftojë Furnizuesin duke treguar natyrën e defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se



dhjetë ditë nga zbulimi. Blerësi do të sigurojë të gjitha mundësitë që Furnizuesi të inspektojë defekte të tilla.

- 18.4** Pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi Mallrat ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Blerësin.

Nëse pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Blerësi mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Furnizimit. Në çdo rast, Blerësi mund të vendosë që të njoftojë Furnizuesin për ndërprerjen e Kontratës.

Neni 19: Zhdëmtimi i Patentës

- 19.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifën e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që pëmdryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) instalimit të mallrave nga Furnizuesi ose përdorimit të mallrave në vendin e dorëzimit të Mallrave;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Mallrat. Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Mallrat ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

- 19.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 19.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

- 19.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij. Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimburohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

Neni 20: Kufizimi i Përgjegjësisë

- 20.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve

ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara;

dhe

- (b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të pajisjeve me defekt, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

Neni 21: Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë

21.1 Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 22: Forca madhore

22.1 Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

22.2 Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

22.3 Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

Neni 23: Modifikimi i Kontratës

23.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

23.2 Blerësi mund t'i paraqesë kërkesë në çdo kohë Furnizuesit, të bëjë modifikime brenda objektit të përgjithshëm të Kontratës në një ose më shumë nga kushtet si vijon:

- (a) vizatimet, skicat ose specifikimet, ku Mallrat që do të furnizohen sipas Kontratës duhet të prodhohen posaçërisht për Blerësin;
- (b) mënyra e dërgesës ose paketimit;
- (c) vendin e dorëzimit; dhe
- (d) Shërbimet e Lidhura që do të ofrohen nga Furnizuesi.

23.3 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për

përlllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

- 23.4** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

Neni 24: Zgjatja e afatit

24.1 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë dërgimin në kohë të Mallrave ose përfundimin e Shërbimeve të Lidhura në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

24.2 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 22, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

Neni 25: Ndërprerja e Kontratës

25.1 Njoftim për të korrigjuar

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

25.2 Ndërprerja për mospërmbushje

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

- (i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 25.1 të këtij neni;
- (ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të dorëzojë ndonjë ose të gjitha Mallrat brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 24;

ose

- (iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

25.3 Ndërprerja për paftësi paguese

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenohet ose ndikohet në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

25.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- (a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

- (b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.
- (c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Mallrat e pranuar dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26: Kufizimet e Eksportit

26.1 Pavarësisht nga çdo detyrim sipas Kontratës për të përfunduar të gjitha formalitetet e eksportit, çdo kufizim eksporti që i atribuohet Blerësit, vendit të Blerësit ose përdorimit të mallrave ose shërbimeve që do të furnizohen, të cilat rrjedhin nga rregulloret tregtare nga një vend që furnizon ato mallra ose shërbime, dhe të cilat në mënyrë të konsiderueshme e pengojnë Furnizuesin për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës, do ta shkarkojnë Furnizuesin nga detyrimi për të ofruar dërgesa ose shërbime, gjithnjë me kusht që Furnizuesi të demonstrojë në mënyrë të kënaqshme për Blerësin që i ka përfunduar të gjitha formalitetet në kohën e duhur, duke përfshirë aplikimet për leje, autorizime dhe licenca të nevojshme për dërgimin e mallrave ose shërbimeve sipas kushteve të Kontratës.

Neni 27: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

27.1 Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

27.2 Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

Kjo kontratë u përpilua në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin. Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palët, të cilët e firmosën dhe e vulosën atë respektivisht në çdo faqe.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR
Universiteti Elbasanit "A.Xhuvani"
ADMINISTRATORI
Eljan HOXHA



PËR KONTRAKTUESIN
"InfoSoft Office" shpk
ADMINISTRATOR
Frederik PRODANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORATI

ANEKS KONTRATA

"Blerje kancelari, tonera, dram e furra për fotokopje e printera"

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi pa Tvsh	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera me tvsh
1	Bateri 6F22 Size 9V	copë	50	92.91	4,645.50	929.10	5,574.60
2	Bateri AA	copë	100	15.07	1,507.00	301.40	1,808.40
3	Bateri AAA	copë	100	15.07	1,507.00	301.40	1,808.40
4	Bllok A5 me spirale me logo Universiteti	copë	1000	92.39	92,390.00	18,478.00	110,868.00
5	Bllok A5 kapak lëkure me logo Universiteti	copë	100	211.11	21,111.00	4,222.20	25,333.20
6	Bllloqe me ngjitje 15 x 75 mm	copë	300	15.20	4,560.00	912.00	5,472.00
7	Bllloqe me ngjitje 75 x 75 mm	copë	300	15.20	4,560.00	912.00	5,472.00
8	CD - R me kuti plastike	copë	500	33.16	16,580.00	3,316.00	19,896.00
9	Dosje arkive 37 x 26 cm	copë	200	20.67	4,134.00	826.80	4,960.80
10	Dosje arkive me butona 12 cm	copë	200	120.44	24,088.00	4,817.60	28,905.60
11	Dosje arkive me butona 15 cm	copë	500	120.44	60,220.00	12,044.00	72,264.00
12	Dosje kartoni A4 (me llastik)	copë	1500	30.00	45,000.00	9,000.00	54,000.00
13	Dosje me 100 qese me kuti	copë	200	345.58	69,116.00	13,823.20	82,939.20
14	Dosje me 80 qese me kuti	copë	100	214.21	21,421.00	4,284.20	25,705.20
15	Dosje me mekanizëm me kuti 5 cm	copë	100	116.67	11,667.00	2,333.40	14,000.40
16	Dosje me mekanizëm me kuti 7 cm	copë	100	129.72	12,972.00	2,594.40	15,566.40
17	DVD - R me kuti plastike	copë	50	35.16	1,758.00	351.60	2,109.60
18	Etiketa - 105 x 148 mm me 4 ndarje	kuti	10	571.91	5,719.10	1,143.82	6,862.92
19	Etiketa - 210 x 148 mm me 2 ndarje	kuti	10	571.91	5,719.10	1,143.82	6,862.92
20	Evidenciator stilo (Textmarker 3A -) Color	copë	250	13.44	3,360.00	672.00	4,032.00
21	Fletore katrore 32 fletë	copë	200	17.78	3,556.00	711.20	4,267.20
22	Gërsherë zyre (20-25 cm)	copë	50	102.51	5,125.50	1,025.10	6,150.60
23	Goma të bardha	copë	20	4.66	93.20	18.64	111.84

Adresa: Rruga "Ismaël Zyma", Elbasan, Tel. +355 54 252593, www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al



Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi pa Tvsh	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera me tvsh
24	Kapse dokumentash binder 19 mm	pako	200	27.89	5,578.00	1,115.60	6,693.60
25	Kapse dokumentash binder 25 mm	pako	200	29.81	5,962.00	1,192.40	7,154.40
26	Kapse dokumentash binder 32 mm	pako	200	44.43	8,886.00	1,777.20	10,663.20
27	Kapse dokumentash binder 41 mm	pako	200	101.60	20,320.00	4,064.00	24,384.00
28	Kapse dokumentash binder 51 mm	pako	200	111.11	22,222.00	4,444.40	26,666.40
29	Korektor stilo	copë	300	24.44	7,332.00	1,466.40	8,798.40
30	Laps grafiti HB	copë	2000	2.50	5,000.00	1,000.00	6,000.00
31	Letër format A3 e bardhë	pako	50	501.09	25,054.50	5,010.90	30,065.40
32	Letër format A4 e bardhë	pako	2500	243.72	609,300.00	121,860.00	731,160.00
33	Letër format A4 me ngjyra	pako	60	525.70	31,542.00	6,308.40	37,850.40
34	Letër shirit adeziv (Letër 80x25.4x0.2 mm) - Printer Custom D4 102	rulon	100	277.78	27,778.00	5,555.60	33,333.60
35	Letër traktor format A4 me 3 kopje color W-P-Y	pako	10	2,111.11	21,111.10	4,222.22	25,333.32
36	Makina llogaritëse - Dual powr 12 digitos 132x172x40 mm	copë	10	465.11	4,651.10	930.22	5,581.32
37	Makinë kapse dokumentesh - inox no 10	copë	10	157.32	1,573.20	314.64	1,887.84
38	Makinë kapse dokumentesh - inox no 24/6 (dore)	copë	100	172.22	17,222.00	3,444.40	20,666.40
39	Mbajtëse natërbani	copë	20	159.98	3,199.60	639.92	3,839.52
40	Ngjitës i ngurtë tub 21 gr	copë	20	9.83	196.60	39.32	235.92
41	Ngjitës shirit transparent 15 x 10	copë	100	8.21	821.00	164.20	985.20
42	Ngjitës shirit transparent rulon i madh	copë	10	51.77	517.70	103.54	621.24
43	Ngjitës transparent stilo 50 gr	copë	10	16.80	168.00	33.60	201.60
44	Profse lapsash	copë	50	5.82	291.00	58.20	349.20
45	Qese plastike dok me vrima - format A4	pako	200	205.56	41,112.00	8,222.40	49,334.40
46	Rapitograf - stilo i zi	copë	300	23.82	7,146.00	1,429.20	8,575.20
47	Rapitograf stilo - blu	copë	300	17.81	5,343.00	1,068.60	6,411.60
48	Shënues dërrasa të bardha - marker tre ngjyra	copë	5000	11.47	57,350.00	11,470.00	68,820.00
49	Shirit karboni 110x25.4x0.39 mm	copë	20	888.89	17,777.80	3,555.56	21,333.36
50	Shirit sinjalizues	rulon	10	240.75	2,407.50	481.50	2,889.00



Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan, Tel. +355 54 252593, www.unie.edu.al, info@unie.edu.al



Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi pa Tvsh	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera me tvsh
51	Stilolapsa me logo Universiteti	copë	3000	22.22	66,660.00	13,332.00	79,992.00
52	Stilolapsa me sistem rrotullimi blu	copë	2000	4.62	9,240.00	1,848.00	11,088.00
53	Stilolapsa me sistem rrotullimi i kuq	copë	1000	4.60	4,600.00	920.00	5,520.00
54	Tabak 160 gr (70*100)	copë	100	46.46	4,646.00	929.20	5,575.20
55	Tela kapse nr 10 rapid	kuti	100	7.51	751.00	150.20	901.20
56	Tela kapse nr 24/6 rapid	kuti	300	11.64	3,492.00	698.40	4,190.40
57	Tela kapse (Delta) 28 mm	kuti	200	21.31	4,262.00	852.40	5,114.40
58	Tela kapse (Delta) 50 mm	kuti	200	28.65	5,730.00	1,146.00	6,876.00
59	USB 32 Gb ndërfaqja 3.0	copë	50	352.22	17,611.00	3,522.20	21,133.20
60	USB 64 Gb ndërfaqja 3.0	copë	50	640.33	32,016.50	6,403.30	38,419.80
61	Vizore 30 cm	copë	50	10.55	527.50	105.50	633.00
62	Zarfa 11 x 23 cm me logo Universiteti	copë	250	18.91	4,727.50	945.50	5,673.00
63	Zarfa 23 x 33 cm me logo Universiteti	copë	250	20.79	5,197.50	1,039.50	6,237.00
64	Zarfa 30 x 40 cm me logo Universiteti	copë	250	26.87	6,717.50	1,343.50	8,061.00
					1,536,850.00	307,370.00	1,844,220.00

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR
Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"
ADMINISTRATORI
Eljan HOXHA

Njësia e prokurimit: Albert Ndreu

Drejtoiria ekonomike: Filip Qosja



PËR KONTRAKTUESIN
"InfoSoft Office" shpk
ADMINISTRATOR
Frederik PRODANI

PERFAQE SHKUR me Produktor



